



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM
Nr. 576, datë 20.11.2020

**PËR
VERIFIKIMIN E PLOTËSIMIT NGA KANDIDATI Z.ASIM VOKSHI
TË TRE KRITEREVE TË KANDIDIMIT PËR NGRITJEN NË DETYRË NË
GJYKATËN E LARTË, PËR DY POZICIONE TË LIRA NË FUSHËN E TË DREJTËS
ADMINISTRATIVE, TË SHPALLURA ME VENDIMET NR. 84, DATË 26.02.2020 DHE
NR. 245, DATË 09.07.2020 DHE PËR POZICIONIN E LIRË NË FUSHËN E TË
DREJTËS CIVILE, TË SHPALLUR ME VENDIMIN NR.87, DATË 26.02.2020, TË
KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR DHE VIJIMIN E PROCEDURËS SË
VERIFIKIMIT PËR KRITERET E TJERA LIGJORE TË KANDIDIMIT**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 20.11.2020, pasi u njoh me materialet e çështjes dhe Relacionin “Për gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e tre prej kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, të kandidatit z. Asim Vokshi”, përgatitur nga relatori z. Ilir Toska, si dhe pasi shqyrtoi propozimin për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. Asim Vokshi, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për dy pozicionet e lira në fushën e të drejtës administrative, të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 84, datë 26.02.2020 dhe nr. 245, datë 09.07.2020 dhe për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 87, datë 26.02.2020, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale” dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit,

VËREN

I. PROCEDURA E VERIFIKIMIT

1. Me Vendimin nr. 84, datë 26.02.2020, Këshilli i Lartë Gjyqësor (më poshtë referuar si Këshilli) ka vendosur:

“1. Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës administrative.

...

3. Afati i kandidimit është pesë muaj nga dita e publikimit të këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

2. Me Vendimin nr. 87, datë 26.02.2020, Këshilli ka vendosur:

“1. Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile.

...

3. Afati i kandidimit është pesë muaj nga dita e publikimit të këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

3. Vendimet e Këshillit si më lart për hapjen e procedurave të kandidimit për në Gjykatën e Lartë, janë publikuar në faqen e tij zyrtare të internetit më datë 28.02.2020, përfshirë dhe një njoftim publik për hapjen e secilës procedurë sipas fushave të së drejtës. Pas publikimit të vendimeve, afatet e kandidimit kanë filluar të ecë nga dita e nesërme, pra nga data 29.02.2020, duke përfunduar këto afate në datë 30.07.2020.

4. Me Vendimin nr. 245, datë 09.07.2020, Këshilli ka vendosur:

“1. Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës administrative.

...

3. Afati i kandidimit është deri më datë 30.07.2020”.

5. Vendimi i Këshillit sipas pikës 4 për hapjen e procedurës së kandidimit për në Gjykatën e Lartë, është publikuar në faqen e tij zyrtare të internetit më datë 09.07.2020, përfshirë dhe një njoftim publik për hapjen e kësaj procedure. Pas publikimit të vendimit, afati e kandidimit ka filluar të ecë nga dita e nesërme, pra nga data 10.07.2020.

6. Brenda afateve të kandidimit, për dy pozicionet e lira në fushën e të drejtës administrative, të shpallura me Vendimet nr. 87, datë 26.02.2020 dhe nr. 245, datë 09.07.2020 dhe për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin nr. 87, datë 26.02.2020, ka kandiduar edhe gjyqtari z. Asim Vokshi (më poshtë referuar si kandidati), aktualisht gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.

7. Me Vendimin nr. 268, datë 07.08.2020, “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për kandidatët nga radhët e gjyqtarëve, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet nr. 84 dhe nr. 87, datë 26.02.2020, si dhe Vendimet nr. 241, nr. 242, nr. 243, nr. 244 dhe nr.245, datë 09.07.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, Këshilli ka vendosur:

“1. Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për kandidatët nga radhët e gjyqtarëve që kanë aplikuar për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet nr.84 dhe nr.87, datë 26.02.2020 (në fushat e të drejtës administrative dhe të së drejtës civile), me Vendimet nr.241, nr.242, nr.243 dhe nr.244, datë

09.07.2020 (në fushën e të drejtës penale), si dhe me Vendimin nr.245, datë 09.07.2020 (në fushën e të drejtës administrative), të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Caktimin e relatorit për secilin kandidat, si më poshtë: ... 3. Për kandidatin z. Asim Vokshi - relator z. Ilir Toska; ...”.

8. Më datë 07.08.2020, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në Seksionin A, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, në rrugë elektronike, kandidati u njoftua: - për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit; - për caktimin e relatorit të kësaj procedure verifikimi; - për të drejtën që kishte për të kërkuar përjashtimin e relatorit të caktuar dhe/ose të çdo anëtar tjetër të Këshillit, brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e këtij njoftimi.

9. Brenda afatit të përcaktuar kandidati nuk parashtroi ndonjë pretendim në lidhje me relatorin e caktuar për procedurën e verifikimit ndaj tij apo për ndonjë anëtar tjetër të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

10. Po të njëjtën datë, bazuar në pikën 8, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, në rrugë elektronike, kandidati iu dërguan formularët dhe autorizimet përkatëse (të përcaktuara në pikën 6, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019) që duhet të plotësoheshin dhe dorëzoheshin prej tij në kuadër të procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit.

11. Brenda afatit pesëditor, kandidati depozitoi rregullisht dokumentacionin e kërkuar të kandidimit, ndërsa një nga dokumentet, pikërisht formularin e deklaratës së pasurisë, sipas Vendimit 75/2019, kandidati duhet ta dorëzojë deri më datë 11.09.2020, pranë ILDKPKI-së.

12. Në vijim të procedurës së verifikimit, më datë 13.08.2020, bazuar në pikën 10, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, përmes shkresave të veçanta, u kërkuar informacion dhe raportim nga institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës, për kandidatët e Gjykatës së Lartë, ndër ta edhe për kandidatin z.Vokshi. Për këto kriterë ligjore kandidimi procedura e verifikimit është në proces e sipër.

13. Sipas pikës 9, të Vendimeve të Këshillit nr. 84 dhe nr.87, datë 26.02.2020 dhe nr. 245, datë 09.07.2020 është përcaktuar se: *“Për kandidatin, për të cilin me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor verifikohet plotësimi i kriterëve ligjore të kandidimit sipas shkronjave “a”, “c” dhe “ç”, të pikës 5, të këtij vendimi, fillon menjëherë procesi i vlerësimit etik dhe profesional: ...”*. Ndërkohë, në pikën 5, shkronja “a”, të Vendimit të Këshillit nr.84, datë 26.02.2020 dhe nr. 245, datë 09.07.2020, përcaktohet se: *“Kriteret ligjore që duhet të plotësojë kandidati për t’u ngritur në detyrë në Gjykatën e Lartë përcaktohen ..., si mëposhtë: a) Kandidati duhet të ketë ushtruar ushtruar funksionin jo më pak se trembëdhjetë vjet në nivele më të ulëta, nga të cilat të paktën pesë vjet në fushën e së drejtës administrative, duke përfshirë edhe përvojën si magistrat i komanduar”*. Ndërsa në pikën 5, shkronja “a”, të Vendimit të Këshillit nr.87, datë 26.02.2020, përcaktohet se: *“Kriteret ligjore që duhet të plotësojë kandidati për t’u ngritur në detyrë në Gjykatën e Lartë përcaktohen ..., si mëposhtë: a) Kandidati duhet të ketë ushtruar ushtruar funksionin jo më pak se*

trembëdhjetë vjet në nivele më të ulëta, nga të cilat të paktën pesë vjet në fushën e së drejtës civile, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar”. Nga ana tjetër, në shkronja “c” dhe “ç”, të pikës 5, të këtyre tre vendimeve, përcaktohet se: “c) Kandidati duhet të mos ketë masë disiplinore në fuqi; ç) Kandidati duhet të mos jetë në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”.

14. Në respektim të vendimeve si më lart të Këshillit, sa i përket plotësimit të tre kritereve formale të sipërpërmendura të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, me qëllim realizimin paralelisht edhe të procedurave të vlerësimit etik dhe profesional të kandidatëve, pra në funksion të përmbylljes sa më parë të procedurave të kandidimit, për kandidatin z. Asim Vokshi u kërkua dhe u administrua informacioni i nevojshëm nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, si organi kompetent për krijimin dhe administrimin e dosjeve personale dhe regjistrin të gjyqtarëve, si dhe nga gjykatat ku kandidati ka ushtruar funksionin e gjyqtarit.

14.1 Për verifikimin e kritereve të “përvojës profesionale minimale” dhe atij të “mospasjes masë disiplinore në fuqi”, Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, me Shkresën nr.3996/1 prot., datë 01.09.2020, përcolli informacionin dhe dokumentacionin përkatës të administruar për kandidatin z. Asim Vokshi, siç do të përshkruhet më poshtë.

14.2 Sa i përket kriterit të “përvojës profesionale minimale” dhe pikërisht nënkriterit të “përvojës specifike profesionale” të kandidatit në fushat e së drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionet e lira ku ai ka kandiduar, pra në fushën e të drejtës administrative dhe atë të së drejtës civile, referuar gjykatave ku kandidati ka ushtruar funksionin e gjyqtarit, konkretisht në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykatën e Apelit Tiranë, informacioni iu kërkua të dyja këtyre gjykatave, për të përcaktuar qartë përvojën specifike të kandidatit në fushën e të drejtës administrative si dhe në fushën e të drejtës civile. Nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë informacioni i kërkuar është përcjell me Shkresën nr. 5350/1 prot., datë 01.09.2020, protokolluar në Këshill me aktin nr. 3984/2 prot., datë 01.09.2020, siç do të përshkruhet më poshtë. Nga Gjykata e Apelit Tiranë informacioni i kërkuar është përcjell me Shkresën nr. 3907/1 prot., datë 28.08.2020, protokolluar në Këshill me aktin nr. 3984/3 prot., datë 03.09.2020, siç do të përshkruhet më poshtë.

15. Pas administrimit të dokumentacionit të nevojshëm, duke çmuar se procedura e verifikimit paraprak në lidhje me tre kriteret formale të kandidimit për kandidatin Asim Vokshi për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, për dy pozicionet e lira në fushën e të drejtës administrative, të shpallura me Vendimet e Këshillit nr. 84, datë 26.02.2020 dhe nr. 245, datë 09.07.2020 dhe për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 87, datë 26.02.2020, ishte e plotë dhe në përputhje me kërkesat e Vendimit 75/2019, më datë 11.09.2020, relatori e parashtrori çështjen përpara Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

16. Komisioni i Zhvillimit të Karrierës e shqyrtoi çështjen më datë 15.09.2020 dhe, pasi vlerësoi të plotë procedurën e verifikimit në këtë rast, bazuar në Seksionin C, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, vendosi kalimin e saj për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor për të vlerësuar dhe vendosur ky i fundit për verifikimin e plotësimin ose jo nga kandidati z. Asim Vokshi, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, për dy pozicionet e lira në fushën e të drejtës administrative, të shpallura me Vendimet e Këshillit nr. 84, datë 26.02.2020 dhe nr. 245, datë 09.07.2020 dhe për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 87, datë 26.02.2020, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

17. Më datë 09.09.2020, bazuar në nenin 146, të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar me Ligjin nr.101/2020(miraturuar më datë 23.07.2020, botuar në Fletoren Zyrtare nr.143, datë 4 Gusht 2020 dhe hyrë në fuqi më datë 19.08.2020), z. Asim Vokshi u përzgjedh me short si anëtar i Kolegjit Zgjedhor. Zgjedhja e tij në këtë detyrë u miratua me Vendimin nr.293, datë 09.09.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Si rezultat i kësaj, ndërsa sipas shkronjës “b”, pika 1, të nenit 149, të këtij Kodi përcaktohej se “*Gjyqtari gjatë ushtrimit të detyrës në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor nuk mund: ...; b) të lëvizet nga detyra në mënyrë të përkohshme apo të përhershme për shkaqe ... apo ngritje në detyrë*”, procedura e verifikimit nuk vijoi në pritje të shqyrtimit nga Kuvendi i Shqipërisë të nismës ligjore, ndër të tjera, edhe për ndryshimin e kësaj dispozite. Me Ligjin nr.118/2020, u shfuqizua togfjalëshi “*apo ngritje në detyrë*”, në shkronjën “b”, pika 1, të nenit 149, të Kodit Zgjedhor. Ky ligj u botua në Fletoren Zyrtare nr.191, datë 3 nëntor 2020, duke hyrë ai në fuqi më datë 18.11.2020.

18. Për rrjedhojë, me rënien e pengesës ligjore më datë 18.11.2020, shqyrtimi i rezultateve të verifikimit paraprak u përfshi në Mbledhjen Plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor të datës 20.11.2020.

II. REZULTATET E VERIFIKIMIT PARAPRAK PËR TRE KRITERET E KANDIDIMIT

19. Për kandidatin z. Asim Vokshi u verifikua kriteri i “përvojës profesionale minimale”.

20. “Përvoja profesionale minimale” për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, që gjen reflektim në shkronjën “a”, të pikës 5, të Vendimeve të Këshillit nr. 84 dhe nr. 87, datë 26.02.2020 dhe Vendimit të Këshillit nr. 245, datë 09.07.2020 është parashikuar si kusht kandidimi në nenin 136, pika 3 (fjalja e parë), të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku përcaktohet se: “*Gjyqtari i Gjykatës së Lartë zgjidhet nga radhët e gjyqtarëve me të paktën 13 vjet përvojë në ushtrimin e profesionit*”. Ndërkohë, “përvoja profesionale minimale” për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë parashikohet dhe në nenin 47, pika 5, të Ligjit për Statusin. Sipas kësaj dispozite, ky kriter kandidimi përbëhet në vetvete nga dy të tillë, ai për për “përvojën e përgjithshme profesionale minimale” dhe ai për “përvojën specifike profesionale minimale”. Konkretisht në këtë dispozitë të ligjit përcaktohet se: “*Magjistrati mund të ngrihet në detyrë në pozicione pranë Gjykatës së Lartë ..., nëse ka ushtruar funksionin jo më pak se trembëdhjetë vjet në nivele më të ulëta, nga të cilat të*

paktën pesë vjet në fushën e së drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionin e lirë, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar”.

21. Për verifikimin e kandidatit në lidhje me plotësimin e këtij kriteri për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë u mbajt parasysh se ai ka kandiduar për tre pozicione të lira, dy pozicionet e lira në fushën e të drejtës administrative dhe një pozicion i lirë në fushën e të drejtës civile, çka do të thotë se kandidati, krahas përvojës së përgjithshme profesionale minimale, që është e njëjtë për të trija kandidimet (në dy fushat e së drejtës), pra jo më pak se trembëdhjetë vjet, duhet të plotësojë edhe përvojën specifike profesionale minimale, pra jo më pak se pesë vjet në fushën e së drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionet e lira, konkretisht në fushën e të drejtës administrative për dy pozicionet e lira të shpallura me Vendimet e Këshillit nr. 84, datë 26.02.2020 dhe nr. 245, datë 09.07.2020 dhe në fushën e të drejtës civile për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 87, datë 26.02.2020.

22. Në lidhje me përvojën e përgjithshme profesionale, në kërkesat për shprehje interesi dhe në jetëshkrimin e dorëzuar nga kandidati rezultoi se, për periudhën 2003-2006 ka ndjekur studimet pranë Shkollës së Magjistraturës. Më datë 03.10.2005, me Dekret të Presidentit të Republikës, është emëruar gjyqtar për të kryer stazhin profesional pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në kuadër të vitit të tretë praktik gjatë studimeve në Shkollën e Magjistraturës. Në periudhën 2005-2006 ka gjykuar të gjitha llojet e çështjeve penale, civile dhe administrative. Me Dekretin e Presidentit të Republikës nr. 5107, datë 06.11.2006, është emëruar përfundimisht gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Duke filluar nga fundi i vitit 2006 dhe deri në çerekun e dytë të vitit 2010, është caktuar nga Kryetari i Gjykatës për të gjykuar pranë Seksionit Administrativ, të Dhomës Civile, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Nga gjysma e dytë e vitit 2010 dhe deri më datë 08.11.2016, ka punuar pranë Seksionit Tregtar-Civil, të Dhomës Civile të të njëjtës gjykatë. Ndërkohë, në vitet 2006-2008 ka ndjekur studimet “Master”, me drejtim civil, pranë Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, ndërsa për periudhën Korrik 2012 - Maj 2013 ka ndjekur studimet master (LL.M) në Universitetin San Diego School of Law, Kaliforni, Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Me Dekretin e Presidentit të Republikës nr. 9826, datë 08.11.2016, është emëruar gjyqtar në Gjykatën e Apelit Tiranë dhe nga kjo datë është caktuar të gjykojë pranë Dhomës Civile të kësaj gjykate, por sipas nevojave të gjykatës ka gjykuar edhe çështje me natyrë penale. Gjithashtu, gjatë viteve 2019 dhe 2020 është komanduar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor për të gjykuar pranë Gjykatës Administrative të Apelit për çështje të caktuara.

23. Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjell nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, kandidati z. Asim Vokshi ka filluar detyrën me Dekretin nr. 4656, datë 03.10.2005, të Presidentit të Republikës, nëpërmjet të cilit është emëruar për të kryer stazhin profesional në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Me Dekretin e Presidentit të Republikës nr. 5107, datë 06.11.2006, ai është emëruar gjyqtar po pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Më pas, me Dekretin e Presidentit të Republikës nr. 9826, datë 08.11.2016, z.Vokshi është emëruar gjyqtar në Gjykatën e Apelit Tiranë, funksion që vijon ta kryejë edhe aktualisht.

24. Nga të dhënat që rezultojnë nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, Këshilli vlerëson se kandidati z. Asim Vokshi, deri në momentin e kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet e Këshillit nr. 84 dhe nr. 87, datë 26.02.2020 dhe Vendimin nr. 245, datë 09.07.2020, ka mbi trembëdhjetë vjet përvojë të përgjithshme profesionale, si gjyqtar në gjykatën e shkallës së parë dhe shkallën e dytë, duke plotësuar kështu kriterin e “përvojës profesionale minimale”.

25. Në lidhje me përvojën specifike profesionale, në kërkesat për shprehje interesi të kandidatit, evidentohet se plotëson kriteret profesionale, pasi ka gjykuar dhe punuar në fushën e të drejtës administrative dhe në fushën e të drejtës civile.

26. Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjell nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, rezulton se:

“... Nga verifikimet e kryera, gjyqtari z. Asim Vokshi, është emëruar për të kryer periudhën e stazhit pranë kësaj gjykate në vitet 2005-2006 dhe po në vitin 2006 është emëruar si gjyqtar duke ushtruar funksionin deri në vitin 2016, vit në të cilin është emëruar gjyqtar i Gjykatës së Apelit Tiranë.

Sa më sipër, bashkëlidhur kësaj shkrese, gjeni në format statistikor, ngarkesën e gjyqtarit të ndarë sipas tipit të çështjes së gjykuar nga gjyqtar z. Asim Vokshi për periudhën 2005-2006, duke ju sqaruar se në tabelën “Ngarkesa e gjyqtarëve”, në rubrikën e shënuar kërkesa civile, janë të përfshirë dhe urdhrat e ekzekutimit. Po ashtu të hedhur në CD (për shkak të volumit të madh të të dhënave në formë të printuar), gjeni ngarkesën si më sipër, si dhe një eksport të regjistrit të vendimeve civile themeli, në të cilën janë të evidentuara dhe objektet konkrete të gjykimit.

Po ashtu lidhur me shoqërimin e informacionit për përvojën e gjyqtarëve në fushat përkatëse, ju kemi informuar në shkresat pararendëse për mungesën e urdhrave të Kryetarit për ndarjen në dhoma/seksione të gjyqtarëve, duke ju vendosur në dispozicion ngarkesën.

Ju informojmë se urdhrat që ne disponojmë janë për periudhën 2012 e në vijim, kopje të të cilave po jua vendosim në dispozicion...”

26.1 Nga verifikimi i dokumentacionit të përcjell, referuar të dhënave, rezulton se kandidati z. Vokshi gjatë gjithë periudhës që ka ushtruar funksionin e gjyqtarit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka gjykuar çështje pranë Dhomës Civile¹, duke përfshirë edhe çështjet penale në fazën paraprake, si gjyqtar i gatshëm.

¹ Konkludime referuar listës së çështjeve/tabelës përmbledhëse dhe të dhënave të regjistrit të vendimeve civile dhe pas vitit 2012, Urdhrit nr. 195, datë 09.01.2014, “Mbi komandimin e gjyqtarëve në seksione dhe trupa gjykues”, ku kandidati z. Vokshi është caktuar të gjykojë në Seksionin Civil dhe Urdhrit nr. 39, datë 03.03.2015, “Mbi organizimin në dhoma dhe seksione të gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë”, ku kandidati z. Vokshi është caktuar të gjykojë në Seksionin Civil.

26.2 Referuar listës² së çështjeve të gjykuara për vitet respektive nuk identifikohen çështjet me natyrë administrative, por ato janë pjesë përbërëse e çështjeve me natyrë civile të përgjithshme, ndërkohë që identifikohen çështjet me natyrë tregtare dhe familjare.

26.3 Ndërkohë, me qëllim verifikimin e përvojës specifike profesionale të kandidatit në fushën e të drejtës administrative, u analizuan të dhënat e regjistrit të vendimeve civile të cilat janë përcjellë në format CD (printuar në KLGJ), nga ku rezultoi se:

26.3.1 Për vitin 2005 nuk rezultojnë të dhëna të gjykimit të ndonjë çështje me natyrë administrative, referuar kjo objektit të kërkesëpadive dhe cilësisë së palëve ndërgjyqëse.

26.3.2 Për vitin 2006 referuar objektit të kërkesëpadisë është një çështje e cila identifikohet si çështje me natyrë administrative, “Padi për shfuqizim/ndryshim akti administrativ”. Ndërkohë që referuar objektit të kërkesëpadisë “Padi për marrëdhënie pune”, dhe palës së paditur, që janë organe të administratës publike, rezultoi që kandidati të ketë gjykuar 3 çështje.

26.3.3 Për vitet 2007, 2008, 2009 dhe për disa muaj të vitit 2010 kandidati z. Vokshi rezultoi të jetë shortuar dhe të ketë gjykuar çështje me natyrë administrative duke marrë për referim në lidhje me këtë vetëm objektit të kërkesëpadive, si “Padi për shfuqizim/ndryshim akti administrativ” apo “Padi për refuzim miratimi akti administrative”. Konkretisht:

² Referuar listës së çështjeve të gjykuara dhe tabelës përmbledhëse, rezultoi se gjyqtari Asim Vokshi:

Për periudhën 01.01.2005 - 31.12.2005, ka gjykuar 22 çështje gjithsej, nga këto: 13 civile të përgjithshme, 8 familjare, 1 kërkesë civile;

Për periudhën 01.01.2006 - 31.12.2006, ka gjykuar 109 çështje gjithsej, nga këto: 5 penale themeli, 46 civile të përgjithshme, 10 familjare, 2 kërkesa penale, 45 masa dhe 1 kërkesë civile;

Për periudhën 01.01.2007 - 31.12.2007, ka gjykuar 198 çështje gjithsej, nga këto: 158 civile të përgjithshme, 5 familjare; 35 kërkesa civile;

Për periudhën 01.01.2008 - 31.12.2008, ka gjykuar 420 çështje gjithsej, nga këto: 1 penale themeli, 262 civile të përgjithshme, 1 tregtare, 5 familjare, 8 kërkesa penale, 42 masa dhe 101 kërkesa civile;

Për periudhën 01.01.2009 - 31.12.2009, ka gjykuar 529 çështje gjithsej, nga këto: 330 civile të përgjithshme, 3 familjare, 3 kërkesa penale, 2 masa, 191 kërkesa civile;

Për periudhën 01.01.2010 - 31.12.2010, ka gjykuar 388 çështje gjithsej, nga këto: 237 civile të përgjithshme, 2 tregtare, 36 masa, 113 kërkesa civile;

Për periudhën 01.01.2011 - 31.12.2011, ka gjykuar 507 çështje gjithsej, nga këto: 238 civile të përgjithshme, 9 tregtare, 27 masa, 233 kërkesa civile;

Për periudhën 01.01.2012 - 31.12.2012, ka gjykuar 327 çështje gjithsej, nga këto: 123 civile të përgjithshme, 6 tregtare, 2 kërkesa penale, 31 masa, 165 kërkesa civile;

Për periudhën 01.01.2013 - 31.12.2013, ka gjykuar 284 çështje gjithsej, nga këto: 113 civile të përgjithshme, 2 tregtare, 1 kërkesa penale, 31 masa, 137 kërkesa civile;

Për periudhën 01.01.2014 - 31.12.2014, ka gjykuar 433 çështje gjithsej, nga këto: 216 civile të përgjithshme, 8 tregtare, 57 masa, 152 kërkesa civile;

Për periudhën 01.01.2015 - 31.12.2015, ka gjykuar 512 çështje gjithsej, nga këto: 207 civile të përgjithshme, 1 tregtare, 1 kërkesë penale, 91 masa, 212 kërkesa civile;

Për periudhën 01.01.2016 - 31.12.2016, gjyqtari Asim Vokshi ka gjykuar 372 çështje gjithsej, nga këto: 160 civile të përgjithshme, 3 kërkesa penale, 74 masa, 135 kërkesa civile.

- a) në vitin 2007, kandidati është shortuar dhe ka gjykuar nga 163 çështje civile të përgjithshme, nga të cilat 70 çështje me natyrë administrative;
- b) në vitin 2008, kandidati është shortuar dhe ka gjykuar nga 268 çështje civile të përgjithshme, nga të cilat 136 çështje me natyrë administrative;
- c) në vitin 2009, kandidati është shortuar dhe ka gjykuar nga 333 çështje me natyrë të përgjithshme, nga të cilat 182 çështje me natyrë administrative;
- d) në vitin 2010, kandidati është shortuar dhe ka gjykuar nga 239 çështje me natyrë të përgjithshme, nga të cilat 67 çështje me natyrë administrative. Nga këto çështje, vetëm 9 të tilla janë shortuar në vitin 2010, referuar datës së regjistrimit, ndërkohë që çështjet e tjera të gjykuara, më së shumti janë regjistruar në gjykatë në vitet 2008 dhe 2009. Shortimi i fundit i gjyqtarit për këtë vit në një çështje me lëndë administrative është bërë në datën 17.09.2010.

26.3.4 Për vitin 2011, kandidati është shortuar dhe ka gjykuar 12 çështje me objekt: “Padi për marrëdhënie pune” ose “Padi kundërshtim veprimesh përmbarimore”, ku në të parat palë e paditur është një institucion publik shtetëror, ndërsa tek të dytat paditësi/kërkuesi është organ publik shtetëror (DRSSH). Ndërkohë kandidati është shortuar dhe ka gjykuar edhe çështje me objekt “Padi të tjera (civile në përgjithësi)/ Korrigjim në aktet e gjendjes civile”, ku palë e paditur është një nga Zyrat e Gjendjes Civile.

26.3.5 Për vitin 2012, kandidati është shortuar dhe ka gjykuar 5 çështje me objekt “Padi kundërshtim veprimesh përmbarimore”, “Korrigjim në aktet e gjendjes civile”, “Padi për marrëdhënie pune”, “Padi të tjera (civile në përgjithësi)”, ku palë ndërgjyqëse janë organe të administratës shtetërore. Ndërkohë, në këtë vit, kandidati ka përfunduar së gjykuari çështje të të njëjtës natyrë, por që janë shortuar vitin e mëparshëm, pra në vitin 2011.

26.3.6 Për vitin 2013, kandidati ka gjykuar 115 çështje civile të përgjithshme, prej të cilave 41 çështje janë me natyrë administrative, referuar kjo objektit të kërkesëpadisë “Padi për shfuqizim/ndryshim akti administrative”, nga të cilat 8 i janë shortuar përgjatë vitit 2012, ndërsa të tjerat përgjatë vitit 2013. Në vitin 2013, ai ka të gjykuara edhe çështje të tjera “Padi për marrëdhënie pune”, “Kundërshtim veprimesh përmbarimore”, ku palë ndërgjyqëse është një organ i administratës publike.

26.4 Verifikimi për gjykimin e çështjeve me natyrë administrative u bë deri në datën 04.11.2013, kohë kur ka filluar funksionimi i gjykatave administrative në bazë të Ligjit 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar. Referuar këtij ligji, fillimisht, në shkronjë “ç”, të nenit 7, përcaktohej se: “Gjykatat administrative janë kompetente për: ...ç) mosmarrëveshjet në marrëdhëniet e punës, kur punëdhënësi është organ i administratës publike”, dispozitë ligjore e cila u ndryshua më pas me Ligjin nr. 39/2017, që përcaktoi se: “Gjykatat administrative janë kompetente për: ...ç) mosmarrëveshjet në fushën e marrëdhënieve të punës të nëpunësve civilë, nëpunësve civilë gjyqësorë, nëpunësve civilë të prokurorisë dhe të

nëpunësve shtetërorë që sipas ligjit organik kanë një rregullim të posaçëm. Përjashtohen nga ky rregull punonjësit në administratën publike, në gjykatë ose prokurori, marrëdhënia e punës e të cilëve bazohet në Kodin e Punës". Për një periudhë më shumë se trevjeçare, konfliktet në fushën e marrëdhënieve të punës, u përfshinë për kompetencë lëndore shqyrtimi si çështje me lëndë administrative, ndërsa me ndryshimet e vitit 2017, u konsideruan si çështje me lëndë administrative vetëm ato të nëpunësve civilë, nëpunësve civilë gjyqësorë, nëpunësve civilë të prokurorisë dhe të nëpunësve shtetërorë që sipas ligjit organik kanë një rregullim të posaçëm. Ndërkohë që konfliktet në fushën e marrëdhënieve të punës me punonjësit në administratën publike, në gjykatë ose prokurori, marrëdhënia e punës e të cilëve bazohet në Kodin e Punës, u përcaktua për kompetencë lëndore shqyrtimi si konflikt civil dhe për rrjedhojë kompetencë shqyrtimi e gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm. Megjithatë, pasur parasysh që për një periudhë të konsiderueshme, të gjitha konfliktet e marrëdhënieve të punës me palë një organ të administratës publike, u konsideruan si konflikte me natyrë administrative, ku palë ndërgjyqëse është një organ i administratës publike, çështje e gjykuara nga kandidati z. Asim Vokshi me objekt "Padi për marrëdhënie pune", ku palë e paditur është një organ i administratës publike, gjatë kohës që kandidati ka qenë në seksionin civil konsiderohen për efekt të përvojës specifike profesionale si çështje të gjykuara në lëndë administrative.

26.5 Përveç sa sipër, në analizën e të dhënave për lëndën e çështjeve të gjykuara nga kandidati, konkretisht asaj administrative, u mbajt parasysh se një kategori çështjesh që tashmë gjykohen nga gjykatat administrative, më parë janë gjykuar nga gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm, seksionet/dhoma civile, të tilla si "Paditë për kundërshtimin e veprimeve përmbareme", ku në cilësinë e paditësit/kërkuesit ka qenë një organ i administratës publike (*psh. DRSSH në rastin e kandidatit z. Vokshi referuar regjistrin të vendimeve civile*) dhe kundërshtohet një veprim që rrjedh nga marrëdhëniet administrative. Kjo në respektim të praktikës së unifikuar të Gjykatës së Lartë, e cila ka mbajtur qëndrimin që: "...9. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në vijim të qëndrimeve të tij të mëparshme, konfirmon se, për kërkimet e palëve dhe mosmarrëveshjet eventuale që mund të lindin mes tyre në fazat e mëvonshme, siç mund të jetë rivendosja në afat, pavlefshmëria e titullit ekzekutiv, kundërshtim i veprimeve përmbareme, që buron nga përmbushja e vullnetit administrativ apo mosmarrëveshja gjyqësore ka në themel konflikt administrativ, kompetenca lëndore për shqyrtimin e tyre i përket gjykatave administrative. Në çdo rast, kur ndodhemi përpara gjykimit të një kërkesë me objekt kundërshtim veprimesh përmbareme, nëse ai buron nga një mosmarrëveshje me natyrë administrative për pasojë edhe gjykimi i saj do të duhet të ndjekë të njëjtin fat, duke diktuar dhe gjykatën që duhet të shqyrtojë çështjen, e cila në rastin në shqyrtim është Gjykata Administrative" (Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë me nr. 00-2018-844, datë 12.09.2018).

26.6 Gjithashtu, në analizën e të dhënave si më lart u mbaj parasysh se edhe çështjet e gjykuara nga kandidati, të identifikuar në regjistrin e vendimeve civile si "Korrigjim në aktet e gjendjes civile" dhe/ose "Padi të tjera (civile në përgjithësi)", me palë të paditur Zyrën e Gjendjes Civile,

në rastet kur kërkohet korrigjimi/ndryshimi i aktit të lindjes, sipas ligjit aktualisht në fuqi për mosmarrëveshjet administrative, klasifikohen si çështje me lëndë administrative³.

27. Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjell nga Gjykata e Apelit Tiranë, rezulton se:

- me Urdhrin e Brendshëm të Kryetarit të Gjykatës nr. 189 prot., datë 15.11.2016, “Mbi shpërndarjen e re të gjyqtarëve (dhomat penale dhe civile)”, kandidati është caktuar të gjykojë në Dhomën Civile;

- me Urdhrin e Brendshëm të Kryetarit të Gjykatës nr. 238 prot., datë 03.12.2018, “Mbi shpërndarjen e re të gjyqtarëve (dhoma penale, civile), kandidati është caktuar të gjykojë në Dhomën Civile.

28. Nga të dhënat që rezultojnë nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, Këshilli vlerëson se kandidati z. Asim Vokshi, deri në momentin e kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet e Këshillit nr. 84 dhe nr. 87, datë 26.02.2020 dhe Vendimin nr. 245, datë 09.07.2020, ka mbi pesë vjet përvojë profesionale në fushën e të drejtës administrative, si dhe në fushën e të drejtës civile, duke plotësuar kështu kriterin e “përvojës specifike profesionale minimale”.

29. Për kandidatin z. Asim Vokshi u verifikua edhe kriteri i “mospasjes masë disiplinore në fuqi”.

30. “Mospasja masë disiplinore në fuqi” si kriter për ngritjen në detyrë edhe në Gjykatën e Lartë, që gjen reflektim në shkronjën “c”, të pikës 5, të Vendimeve të Këshillit nr. 84 dhe 87, datë 26.02.2020 dhe Vendimit nr. 245, datë 09.07.2020, është parashikuar në nenin 48, pika 8, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: *“Vetëm kandidatët të cilët ... nuk kanë masa disiplinore në fuqi, pranohen në procedurat e mëtejshme të ngritjes në detyrë”.*

31. Në lidhje me këtë kriter, në rastin e aplikimit, kandidati ka depozituar formularët e Vetëdeklarimit “Për masa disiplinore” datë 24.07.2020, nëpërmjet të cilëve, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, ka deklaruar se: *“Nuk kam masë disiplinore në fuqi”.*

32. Sipas informacionit të përcjell nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, kandidati z. Asim Vokshi nuk ka masa disiplinore në fuqi.

³ Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në vendimin nr. Nr. 00 - 2018 - 107, datë 16.01.2018, ndër të tjera, ka arsyetuar se: *“51....omissis...pala e paditur, Zyra e Gjendjes Civile, në kuadër të veprimtarisë së saj administrative është organi publik që ka kompetencën ligjore për korrigjimin e “aktit të lindjes” dhe ky i fundit përbën një akt administrativ me natyrë individuale. Për këto arsye, duke qenë se kërkimet e paditësit në këtë proces gjyqësor dhe shkaku ligjor ku ato mbështesin këto kërkime janë të lidhura me korrigjimet e akteve të gjendjes civile (aktit të lindjes së paditëses), çështja objekt gjykimi përbën një mosmarrëveshje administrative dhe hyn në rrethin e atyre çështjeve që janë në kompetencë lëndore të gjykatave administrative, (neni 7/a i Ligjit nr. 49/2012)”.*

33. Nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, Këshilli vlerëson se nuk vërtetohet që kandidati z. Asim Vokshi të ketë masë disiplinore në fuqi, duke plotësuar kështu kriterin e “mospasjes masë disiplinore në fuqi”.

34. Për kandidatin z. Asim Vokshi u verifikua edhe kriteri i “papajtueshmërisë ambientale”.

35. Papajtueshmëria ambientale si kriter ndalues për ngritjen në detyrë edhe në Gjykatën e Lartë, që gjen reflektim në shkronjën “ç”, të pikës 5, të Vendimeve të Këshillit nr. 84 dhe 87, datë 26.02.2020 dhe Vendimit nr. 245, datë 09.07.2020, është parashikuar në nenin 8, pika 2, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: *“Këshillat, gjatë ... ngritjes në detyrë të magistratit, për aq sa është e mundur dhe pa cenuar në mënyrë jopropocionale të drejtën për zhvillimin normal të karrierës profesionale të magistratit, marrin masa për të shmangur papajtueshmërinë ambientale, sipas pikës 3, të këtij neni, me qëllim që të garantohet besimi i publikut në sistemin e drejtësisë, pavarësia dhe paanësia e magistratit, eficienta e gjykatave dhe zyrave të prokurorisë në dhënien e drejtësisë”.* Ndërkohë, kuptimi i papajtueshmërisë ambientale përcaktohet në pikën 1, të kësaj dispozite ligjore, sipas të cilës: *“Papajtueshmëria ambientale, në kuptimin e këtij neni, krijohet për shkak të lidhjeve të ngushta familjare mes magistratëve, që janë përkatësisht bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, ose të afërmit e tij deri në shkallë të dytë”.* Sa i takon rasteve të papajtueshmërisë ambientale për sa lidhet me ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, ato parashikohen në pikën 3, shkronja “a”, të kësaj dispozite ligjore, ku përcaktohet se: *“Papajtueshmëria ambientale përbëjnë rrethanat e mëposhtme: a) nëse respektivisht në të njëjtën gjykatë ose prokurori ku magistrati kërkon të caktohet, ushtron funksionin një magistrat tjetër, që ndodhet në kushtet e pikës 1 të këtij neni”.*

36. Në lidhje me papajtueshmërinë ambientale, në rastin e aplikimit, në përputhje me detyrimin sipas nenit 8, pika 5, të Ligjit për Statusin, kandidati ka depozituar formularët e Vetëdeklarimit “Për situatën e papajtueshmërisë ambientale” datë 24.07.2020, nëpërmjet të cilëve, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, ka deklaruar se: *“Nuk do të ndodhem në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”.*

37. Gjatë verifikimit nuk rezultoi ndonjë e dhënë e ndryshme nga ajo e deklaruar nga kandidati në lidhje me situatën e papajtueshmërisë ambientale për sa ai kandidon për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë.

38. Nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, Këshilli vlerëson se për kandidatin z. Asim Vokshi nuk vërtetohet të ndodhet në situatën e papajtueshmërisë ambientale në rast të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, duke plotësuar kështu kriterin e “papajtueshmërisë ambientale”.

III. KONKLUZIONE

39. Referuar kërkesave të Vendimit 75/2019, duke mbajtur parasysh edhe përcaktimet e Vendimeve nr. 84 dhe nr. 87, datë 26.02.2020 dhe nr. 245, datë 09.07.2020, nga shqyrtimi i

dokumentacionit të administruar gjatë procedurës së verifikimit paraprak të tre kritereve formale të kandidimit të z. Asim Vokshi, për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se procedura e verifikimit e ndjekur në këtë rast është e plotë dhe në përputhje me ligjin.

40. Bazuar në sa më lart është parashtruar mbi rezultatet e verifikimit paraprak të tre kritereve formale të kandidimit për kandidatin z. Asim Vokshi, konkretisht të kritereve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se kandidati i plotëson ato, ndërsa nuk ekziston ndonjë shkak për skualifikimin e tij nga kandidimi në lidhje me këto kritere. Nisur nga kjo, Këshilli çmon se është vendi për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. Asim Vokshi, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, të tre kritereve të sipërpërmendura të kandidimit dhe vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatit për kriteret e tjera ligjore në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për dy pozicionet e lira në fushën e të drejtës administrative, të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 84, datë 26.02.2020 dhe nr. 245, datë 09.07.2020 dhe për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 87, datë 26.02.2020.

PËR KËTO ARSYE

Mbështetur në pikën 3, të nenit 136, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 8, në pikën 5, të nenit 47, në pikën 8, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimin e tij nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, si dhe në pikën 9, të Vendimeve të tij nr. 84, datë 26.02.2020 dhe nr.245, datë 09.07.2020, “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës administrative”, si dhe nr. 87, datë 26.02.2020, “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile”, Këshilli i Lartë Gjyqësor,

V E N D O S I :

1. Verifikimin e plotësimit nga kandidati z.Asim Vokshi, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për dy pozicionet e lira në fushën e të drejtës administrative, të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 84, datë 26.02.2020 dhe nr. 245, datë 09.07.2020 dhe për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 87, datë 26.02.2020, të kritereve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për dy pozicionet e lira në fushën e të drejtës administrative, të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 84, datë 26.02.2020 dhe nr. 245, datë 09.07.2020 dhe për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 87, datë 26.02.2020.
3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z.Asim Vokshi sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR